



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. 3786 Prot

Shkodër, më 21.03 .2017

**VENDIM**

Nr. 100 , datë 21.03 .2017

Bazuar në nenin 8, 9 të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr 44/2015 " Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

**VENDOSA:**

1. Miratimin e rregullores së funksionimit të Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Shkodër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**





BASHKIA  
SHKODËR

**Rregullore e Funkcionimit të Sistemit të  
Taksave dhe Tarifave Vendore**

---

**SiTTV**

Kjo rregullore ka për synim të përcaktojë mënyrën e funksionimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore dhe detyrat e njësisive të Bashkisë Shkodër që janë të angazhuar në sistemin e administrimit të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Sistemi për administrimin e taksave dhe tarifave vendore synon përshtatjen e funksionaliteteve të programit për të rritur cilësinë e shërbimit nëpërmjet rritjes së transparencës, uljes së kohës dhe kostos së marrjes së shërbimit, si dhe rritjes së efikasitetit të administratës në ofrimin e shërbimeve ndaj taksapaguesit.

### **Akronime**

SiTTV – Sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore

### **Fusha e zbatimit**

- Rregullat e përgjithshme të procedurave për regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore përmes SiTTV, zbatohen nga Drejtoria e të Ardhurave e Bashkisë Shkodër.
- Rregullat e përgjithshme të procedurave për regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore përmes SiTTV, zbatohen dhe nga njësitë administrative të Bashkisë Shkodër.
- Rregullat e përgjithshme të procedurave për regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore përmes SiTTV, bëhen të detyrueshme që të zbatohen dhe nga institucionet e varësisë së Bashkisë Shkodër, në të cilat në të ardhmen do të instalohet SiTTV.

### **Regjistri i taksapaguesve**

Spektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit, Spektori i Regjistrimit, Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave Familjare dhe Spektori i Kontrollit, Verifikimit dhe Masave Shtrënguese janë përgjegjës për regjistrimin taksapaguesve jo familjare (biznese) dhe familjare.

Taksapaguesit jofamiljare identifkohën në mënyrë unike nëpërmjet numrit unik të identifikimit (NIPT).

Taksapaguesit familjarë identifkohën në mënyrë unike nëpërmjet numrit personal ID, të kryefamiljarit.

### Shtimi i një taksapaguesi në regjistrin e taksapaguesve

Shtimi i taksapaguesit jofamiljar në regjistrin e taksapaguesve bëhet nga Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit.

Për taksapaguesin jofamiljar regjistrohen të dhënat e mëposhtme, bazuar në informacionin periodik nga QKB:

- Kodi i identifikimit ( NIPT)
- Emri
- Kategoria e taksapaguesit
- Aktiviteti
- Natyra e veprimtarisë
- Data e fillimit të aktivitetit
- Statusi (Aktiv/Pasiv/Mbyllur/Pezulluar)
- Adresa
- Administratorët

si dhe nga akt kontrollet e kryera nga verifikimi në terren:

- Adresa
- Aktiviteti
- Periudha e aktivitetit
- Sipërfaqe ndërtese, trualli, hapësire publike (në rastet kur ka)
- Informacion mbi tabelat (lloj tabele, sipërfaqe tabele)

Shtimi i taksapaguesit familjar në regjistrin e taksapaguesve bëhet nga Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave Familjare.

Për taksapaguesin familjar regjistrohen të dhënat e mëposhtme:

- Nr personal
- Taksapaguesi (Emri, atësia, mbiemri)
- Kategoria e kryefamiljarit
- Adresa
- Anëtarët e familjes

## Gjenerimi i detyrimeve

Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit dhe Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave Familjare janë përgjegjës për verifikimin dhe konfirmimin e detyrimeve për Taksat dhe Tarifat Vendore.

Bazuar në informacionin e plotësuar për çdo adresë, bëhet gjenerimi automatik i kategorive të taksave dhe tarifave vendore si dhe llogaritja e detyrimeve vjetore në përputhje me paketën fiskale të Bashkisë Shkodër.

## **Faturimi i një taksapaguesi**

### Faturimi për Detyrimet Vendore Vjetore

Programi i administrimit të taksave dhe tarifave vendore duhet të mundësojë krijimin e faturave për detyrimet vendore vjetore sipas përcaktimit në paketën fiskale të vitit përkatës. Faturimi i taksapaguesit behet nga Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit dhe Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave Familjare.

Me faturimin lind detyrimi i taksapaguesit për pagesë. Programi duhet të ndjekë logjikën me faza për llogaritjen e detyrimeve, faturimin, pagesën, gjobat, veprimet rregulluese, rakordimin:



### Faturimi në grup

Programi mundëson faturimin në grup për detyrimet vendore vjetore të taksapaguesve, duke shfrytëzuar motorrin e llogaritjes për llogaritjen e detyrimeve për secilin nga taksapaguesit individual. Programi mundëson përcaktimin e grupeve për faturim në grup të detyrimeve vendore, sipas Njësisë Administrative ose lagjeve.

### Faturimi për tarifatat e shërbimeve administrative

Drejtoria e Planifikimit dhe Regjistrimit të të Ardhurave në Bashki është një nga hallkat e rrjedhës së punës për trajtimin e kërksave për shërbime nga qytetarët dhe bizneset. Për disa shërbime kjo drejtori krijon faturën për arkëtim për shërbimin e kërkuar nga qytetari nëpërmjet Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë. Fatura e krijuar nëpërmjet Sistemit të Zyrës me Një Ndalesë pasqyrohet automatikisht në programin e administrimit të taksave dhe tarifave vendore.

### **Auditimi i veprimeve me faturat**

Për efekt të ndjeshmërisë që kanë veprimet mbi faturat ruhen në tabela auditit. Për çdo detaj të faturës ruhet informacion mbi përdoruesin që e shtoi dhe kohën.

Më pas për çdo modifikim, ruhet përdoruesi, koha dhe ndryshimet e bëra.

Hedhja e pagesave për një taksapagues

Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit të të Ardhurave, është përgjegjës për hedhjen e pagesave sipas rakordimeve periodike të ardhura nga Dega e Thesarit në favor të Bashkisë Shkodër.

Çdo muaj përpilohet evidenca mujore e të ardhurave të arkëtuara të muajit të kaluar në bazë të klasifikimit ekonomik të të ardhurave. Pagesat mund të jenë të plota ose të pjesshme (2 ose më shumë pagesa për një faturë) duke mirëkuptuar nevojat dhe disponueshmërinë e taksapaguesit për të shlyer detyrimet brenda afatave të përcaktuara.

Bazuar në Paketën Fiskale, në rastet kur detyrimet nuk shlyhen brenda afatit të përcaktuar, aplikohen kamatëvonesa, të cilat llogariten në mënyrë automatike.

SiTTV mundëson ndarjen e pagesave, të cilat arkëtohen në bankat e nivelit të dytë, në llogari të Degës Thesarit Shkodër nëpërmjet disa kanaleve siç janë:

- Arka
- Banka
- Posta
- Urdhër-Transferta (në rastin e transferimeve ndërmjet institucioneve buxhetore ose Njësive të Vetqeverisjes Vendore)
- "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a, Shkodër

Pas përpilimit të evidencës mujore të të ardhurave, bëhet evidencë analitike e të ardhurave për Bashkinë Qender dhe çdo njësi administrative sipas pagesave të hedhura në sistem.

### Auditimi i veprimeve me pagesat

Për efekt të ndjeshmërisë që kanë veprimet mbi pagesat ruhen në tabela auditi. Për cdo detaj të pageses ruhet informacion mbi përdoruesin që e shtoi, kohën dhe mënyrën e pagesës.

Për çdo modifikim që ka nevojë për nderhyrje sipas dokumentacionit të paraqitur, në sistem jepen të dhënat e përdoruesit, koha dhe ndryshimet e bëra.

Sektori i Kontroll-Verifikimit dhe Masave Shtrenguese, nëpërmjet SiZ1N-së bën bashkangjtitjen në sistem të akt kontrolleve, të cilët lexohen nga Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit.

### **PAKETA FISKALE**

SiTTV është në gjëndje të administrojë paketën fiskale për çdo vit. Paketa fiskale përfaqësohet nga lista e taksave, tarifave vendore, të ardhura të tjera të aplikueshme në vitin fiskal përkatës. E njëjta taksë apo tarifë mund të aplikohet në disa vite, siç edhe mund të ketë nga viti në vit taksa dhe tarifa të reja.

Në këtë modul përcaktohet dhe numri i kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e shlyerjes së detyrimeve.

### Taksat

Për secilën nga taksat dhe tarifat ruhen informacionet e nevojshme për administrimin e saj ndër të cilat:

- kodi ekonomik
- emërtimi
- baza e taksës
- njësia matëse
- mënyra e llogaritjes

Secila nga taksat dhe tarifat mund të ketë kategori dhe nënkategori sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar vit pas viti me vendim të Këshillit Bashkiak.

### Raporte

Raportet përbëjnë tiparin kryesor të kontabilitetit sepse janë mjetet e para të komunikimit dhe informimit kontabel dhe lejon vlerësimin e profitabilitetit të taksapaguesit dhe ndikojnë në vendimarrjet në favor të një periudhe të ardhshme. Raportet janë ndërtuar bazuar në nevojat e përditshme të specialisteve si:

### **Regjistri i taksapaguesve**

Paraqet të dhëna të detajuara për çdo taksapagues individ/biznes/OJF/ Institucion etj, (ID/NIPT, kategori biznesi, llojin e aktivitetit, adresen, sipërfaqe ndërtese dhe trualli, toke bujqësore, sipërfaqe tabelle, datë fillimi dhe mbyllje aktiviteti, statusin e subjektit.

### **Raport aktiviteti**

Raporti paraqet subjektet aktive në vit fiskal.

### **Raport fatura**

Paraqet të dhëna mbi faturat e krijuara nga çdo taksapagues individ/biznes/OJF/ Institucion etj e identifikuar me të dhëna ID/NIPT, adresen, numrin e faturës, datën e krijimit të faturës, periudhën e caktuar fiskale si dhe faturat përmbledhëse dhe analitike, sipas zërave të taksavë dhe tarifave vendore.

### **Raport Pagesa**

Paraqet të dhëna mbi pagesat e kryera nga çdo taksapagues individ/biznes/OJF/ Institucion etj e identifikuar me të dhëna ID/NIPT, llojin e aktivitetit, adresen dhe mënyrën e pagesës për periudhën e caktuar fiskale si dhe evidencën sipas taksave dhe tarifave mujore ose progresive. Ky raport paraqet gjithashtu edhe pagesat e bëra sipas njësive administrative.

### **Detyrimet vjetore të faturuara**

Paraqet detaje mbi taksat/tarifat vjetore të detyrueshme për çdo taksapagues, sipas Paketës Fiskale të miratuar me VKB

### **Raport i të ardhurave**

Paraqet balancën ndërmjet vlerës së faturuar dhe vlerës së paguar për çdo zë fature

### **Gjendja krahasuese (Gjendja aktuale)**



Paraqet të dhëna mbi vlerat e faturuara dhe vlerat e paguara për çdo taksapagues jo familjar

### **Gjendja aktuale familjarët**

Paraqet të dhëna mbi vlerat e faturuara dhe vlerat e paguara për çdo taksapagues familjar

### **Lista e debitorëve**

Paraqet të dhëna mbi taksapaguesit debitorë biznes/individ për taksa dhe tarifa për vitin fiskal ose të gjitha vitet për periudha faturimi dhe pagese të caktuara. Për sa i përket këtij raporti mund të nxirret të dhënat e çdo biznesi/individ me status aktiv/pasiv/mbyllur/pezulluar për çdo njësi adrese dhe vleren përkatëse debitore. Nga kyraport në fund të çdo viti fiskal nxirren edhe debitorët e institucioneve të varësisë për rakordim me Drejtorinë e të Ardhurave.

### **Lista e njoftim detyrimeve**

Paraqet të dhëna mbi njoftim detyrimet e printuara

### **Bizneset jashtë bashkisë**

Paraqet subjektet pa asnjë adresë ekzistuese.

### **Ditari i puneve**

Raporti paraqet informacion të përgjithshëm mbi veprimet e çdo punonjësi, ne nje periudhe te caktuar